



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA HIMARE  
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM NR. 77 DATE 25.11.2016

**“ PER PAKETEN FISKALE TE VITIT 2017 ” BASHKIA E HIMARES**

Baza ligjore :

- Ligji nr.139/2015, “Per veteqeverisjen vendore” ,
- Ligji nr. 9632 date 30/10/2006 “Per sistemin e taksave vendore” i ndryshuar.
- Ligji nr.181/2013, “Per disa shtesa ndryshime te ligjit nr.9632, per sist. e taksave ne R.SH”
- Ligji nr. 142/ 2015, Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin 9632 dt.30/10/2006.
- Ligji nr.178/2013, “Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin 9975 dt.287.2008 per Taxat K.”
- Ligji nr.179/2013, “Per shtesa dhe ndrysh.ligjin 9920 dt.19.5.2008, per procedurat tatimore”
- VKM nr. 1712 date 24/12/2008, “Per dhenien me qera ose enfiteoze te pasurive shtetere”

Keshilli i Bashkise Himare, i mbledhur me daten 25/11/2016, pasi mori ne shqyrtim Projekt vendimin e Bashkise si dhe relacionin perkates per Paketën Fiskale te vitit 2017 dhe e diskutoi atene teresi e vec e vec, ne perfundim me 12 vota pro dhe 2 kunder;

**V e n d o s i :**

Te miratoje paketën fiskale me ndryshimet e propozuara sipas lidhjes bashkangjitur.

Lidhja nr. 1 e Paketës Fiskale sipas VKB date 25/11/2016, do te jete si me poshte.

**I- Ne taksat vendore perfshihen :**

- 1-Taksa vendore mbi biznesin e vogel. (Tatim i thjeshtuar mbi Fitimin)
- 2-Taksa mbi pasurin e paluajtshme. (Mbi ndertesat, Truallin dhe token bujqesore).
- 3-Taksa vendore e fjetjes ne Hotel.
- 4-Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja.
- 5-Taksa e kalimit te drejtes se pronesise per pasurit e paluajtshme.
- 6-Taksa e rregjistrimit te pervitshem te mjeteve.
- 7-Taksa e Tabeles.
- 8-Taksa te perkoheshme.

**II-Ne Tarifat vendore perfshihen :**

- 1-Tarifa per sherbime komunale, (ndricim, gjelberim, sherbime)
- 2-Tarifa e sherbimeve veterinerë dhe te tjera.
- 3-Tarifa e sherbimit te pastrimit urban.
- 4-Tarifat per zenien e hapësirave publike
- 5-Tarifat e sherbimeve administrative dhe zyrtare.
- 6-Tarifat e sherbimit per subjektet e ndertimit.
- 6-Tarifat per qera kullota, bime medicinale dhe te tjera.
- 8-Tarifat e sherbimit ne tregjet publike.

## I. TAKSAT VENDORE

Llojet, baza tatimore, kategorizimet dhe nenkategorizimet, kestet e pagimit, koha e kryerjes se tyre, kushtet lehtesuese dhe agjenti tatimor.

### 1. TATIMI MBI FITIMIN PER BIZNESIN E VOGEL

Ne kuptim te T.TH.F. kemi parasysh; - Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal nje qarkullim nga 5 milione deri ne 8.000.000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin vogël.

Të ardhurat gjithsej te realizuara nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to, të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.

1. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 5 për qind.

2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë, është 0 (zero) lekë në vit.”.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, vepron si agjent tatimor, i ngarkuar me mbledhjen, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Administrata tatimore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuar taksat.

Administrata tatimore, për shërbimin që kryen si agjent tatimor, merr një komision. Ky komision llogaritet në përqindje të shumës së tatimit që kanë arkëtuar dhe kanë transferuar në buxhetin e njërive të qeverisjes vendore, komision i cili është në masën 1 për qind dhe derdhet në llogari të administratës tatimore. Komisioni si agjent tatimor kalon në llogari të buxhetit të shtetit, në bazë të legjislacionit në fuqi mbi përdorimin e të ardhurave dytësore, të krijuara në institucionet buxhetore dhe për mbulimin e kostove të “Pullave të tatimit”

### 2- TAKSA MBI PASURINE E PALUAJTSHME

Taksat mbi pasurine e paluajtshme i nënshtrohet çdo individ, person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, pronar i pasurisë së paluajtshme në territorin, nën juridiksionin e Bashkisë Himare, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të pasurisë. Bejne perjashtim rastet kur ne ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurine e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkepronari, sipas pjesës që zoteron.

Taksat mbi pasurine e paluajtshme llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësive.

Siperfaqja në pronësi e taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që vertetojnë pronësinë të leshuara nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP).

Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesi, Zyrat e Taksave të Bashkisë, për vertetim pronësie njohin:

- a) vendimet e komisionit të kthimit dhe kompesimit të pronës
- b) vendimet e privatizimit

c) dokumentat e tjera te leshuara nga organet perkatese shteterore ne perputhje me legjislacionit perkates.

Ne rastin e mungeses se dokumentacionit te vertetimit te pronesise, madhesia e siperfaqes se tatueshme percaktohet me vendim nga Komisioni i verifikimit te pasurive te paluajtshme.

Ne rastet e siperfaqes se ndertesese te dhene ne perdorim, nese ne marreveshjen midis pronarit dhe perdoruesit eshte percaktuar detyrimi i ketij te fundit per pagimin e takses mbi pasurine e paluajtshme, madhesia e siperfaqes se pasurise se taksueshme do te percaktohet ne baze te dokumentit (kontrate /marreveshje) te lidhur mes paleve.

Ne rast se nje prone shtrihet ne territorin e me shume se nje bashkie, pavaresisht nga vendbanimi i pronarit, secila njesi vendore e trajton pjesen e prones, qe ndodhet brenda territorit te vet, si prone me vete dhe zbaton mbi te dispozitat e ketij ligji.

Ne taksat mbi pasurine e paluajtshme perfshihen:

- Taksa mbi ndertesën.
- Taksa mbi Truallin
- Taksa mbi token bujqesore.

### **2.1- TAKSA MBI NDERTESEN**

- Baza e takses mbi ndertesat eshte siperfaqja e ndertimit ne meter katror e ndertesese ose e pjeses se saj, mbi dhe nen nivelin e tokes dhe per çdo kat. Detyrimi per taksen llogaritet si shumezim i nivelit te takses me bazen e taksueshme.

Taksës mbi ndertesat i nënshtrohen edhe taksapaguesit, te cilet kane, ne perdorim apo ne pronesi, ndertesat brenda teritoreve te miratuara si fshatra turistike. Siperfaqja e ndertesese, ne perdorim apo pronesi, percaktohet ne baze te dokumenteve, qe vertetojne perdorimin ose pronesine e saj.

Taksa mbi ndertesën llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit.

Personat fizikë, të cilët kanë më shumë se një shtëpi, për shtëpinë ku kanë banimin e zakonshëm, paguajnë taksën e ndertesës sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi, ndërsa për të gjitha shtëpitë e tjera, taksa e ndertesës është sa dyfishi i taksës së ndertesës, që zbatohet në zonën ku ndodhet kjo ndertesë.

Për ndertesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pashitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndertesës. Ambientet e hipotekuara si:

- Apartamente banimi do t'i nënshtrohen taksës mbi ndertesat në kategorinë "Ndertesat banimi";
- Ndertesat biznesi do t'i nënshtrohen taksës mbi ndertesat në kategorinë "Ndertesat të tjera për tregti dhe shërbime". **"Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i ndertesës bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së ndertesës, pranë bashkisë ku ndodhet ndertesat."**

- Kategorite dhe nenkategorite minimale te bazes se takses dhe nivelet treguese te takses per çdo kategori minimale te bazes per taksen mbi ndertesën; eshte si vijon:

**Taksa mbi ndertesat do te jete sipas tabelës me poshte :**

Nr	Kategoria e Ndertesese	Emertimi i llojit apo destinacionit te ndertesese	Niveli i takses leke/m <sup>2</sup> ne vit
1	I-Ndertesat Banimi	Ndertesat e banimit ndertuar para vitit 1993	5 leke/m <sup>2</sup>
2		Ndertesat e banimit ndertuar gjate dhe pas vitit 1993	6 leke/m <sup>2</sup>
3	II-Ndertesat te tjera	Ndertesat per Tregeti dhe Sherbime	200 leke/m <sup>2</sup>
4		Ndertesat te tjera	40 leke/m <sup>2</sup>
5		Ndertesat per perdorim per veprimtari Prodhimi	100 leke/ m <sup>2</sup>
6	III-Ndertesat Turistike	Ndertesat ne pronesi apo ne perdorim te infrastruktures turistike	400 leke m <sup>2</sup>

## - Paketa Fiskale 2017 -

**Shënim I: Niveli i Takses se kesaj tablete eshte llogaritur per Njesine Administrative Himare. Per njesit e tjera administrative Lukove dhe Hore-Vranisht niveli i kesaj takse per te gjitha kategorite eshte 50% me pak.**

**Shënim II:** Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shtije, por që janë ende të pashitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës. Ambientet e hipotekuara si:

- apartamente banimi do t'i nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "Ndërtesa banimi";
- ndërtesë biznesi do t'i nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë "Ndërtesa të tjera për tregti dhe shërbime".

**Shënim III:**

a- Detyrimin për taksën e ndërtesës, i nënshtrohen të gjithë taksapaguesit, (po dhe jo banorë të Himares), që disponojnë objekte të cdo lloji të ndërtuara në të gjithë territorin e Bashkisë Himare.

b-Perjashtohen nga pagesa e kesaj takse; qe parashikohen nga dispozitat sipas ligjit nr.7889 date 14.12.1994, per Invalidet dhe veteranet e LANCL, te cilet perjashtohen nga taksat e drejtperdrejta.

c- Siperfaqia e ndërtesës dhe vleresimi i takses behet ne baze te dokumentit te lejes se ndertimit ose vertetimit hipotekor si dhe i matjes ose inventarizimit te kryer nga organi i specializuar dhe i autorizuar nga Drejtoria e tatim taksave te Bashkise.

d- Taksa mbi ndërtesat kryhet me një kest dhe paguhet nga taksapaguesi deri me datën 30 Qershor të vitit në vazhdim.

e-Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe vjeljen e kesaj takse eshte Drejtoria e Taksa-Tarifave te Bashkise Himare, ose Agjenti tatimor, ne rast te perzgjedhjes se ketij te fundit.

**Shënim IV-** Taksat për ndërtesat që perdoren për veprimtari prodhuese pergjysmohet ½ e takses.

### 2.2- TAKSA MBI TOKEN BUJQESORE.

(Ligji nr.9632 dt.30/10/2006 neni 23, i ndryshuar)

Nr	Klasifikimi i kategorise se tokes sipas bonitetit dhe pergjegjesia tatimore sipas fshatrave te Bashkise	Leke / ha ne vit
1	I	5.600
2	II	4.900
3	III	4.200
4	IV QAZIM PALI,	3.600
5	V LUKOVE, PIQERAS, SASAJ, QEPARO	3.000
6	VI NIVICE, BORSH,	2.400
7	VII – X TE GJITHE TE TJERET NE TERRITORIN E BASHKISE HIMARE,	1.800

*-Kjo takse per Bashkine Himare do te jete kategoria VII-X-te, perjashtur fshatrat QazimPali qe do te jete kategoria IV-te, Qeparo, Lukove, Sasaj & Piqeras do te jete kateg. V-te, Nivice & Borsh qe do te jete kategoria VI-te, sipas klasifikimit te bonitetit te tokes.*

**"Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka."**

**Perjashtohen nga pagesa e takses se mesiperme:**

-Personat te cilat kane te ardhura nen minimumin jetik te nivelit kombetar, percaktimi i te cileve behet me vendim te Keshillit Bashkiak ose personat e caktuar prej tij; Kryetari i Bashkise dhe Drejtori i Taksave.

-Tatim paguesi pasuria e te cilit eshte demtuar nga forca madhore. Masa e lehtesise tatimore te jete e njejte me masen e demit te shkaktuar por jo me shume se 75 % te vleres se t'ardhurave.

-Te gjitha ato toka te zena me mbjellje te reja drufutrore, agrume, ullinj dhe vreshta nga data e mbjelljes per 5 vite rresht. Per keto familja fermere paraqet nje vertetim nga DMMT ne Drejtorine e Tatim-Taxave.

-Sipas ligjit nr.7889 date 14.12.1994, (Invalidet dhe veteranet e LANCL, perjashtohen nga taksat e drejtperdrejta).

Vjelja e takses mbi token bujqesore behet me nje kest nepermjet bankes nga Drejtoria e Tatim Taxave ose nga Agjenti Tatimor, ne rastet kur eshte vendosur dhe perzgjedhur nje i tille.

**2.3- TAKSA MBI TRUALLIN.**

1. BAZA E TAKSËS MBI TRUALLIN ËSHTË SIPËRFAQJA E TRUALLIT, NË METËR KATROR, NË PRONËSI APO PËRDORIM TË TAKSAPAGUESIT. SIPËRFAQJA E TRUALLIT NË PRONËSI PËRCAKTOHET SIPAS DOKUMENTEVE QË E VËRTETOJNË ATË. NË RAST TË MUNGESËS SË DOKUMENTACIONIT TË PRONËSISË, PËRDORUESI I TRUALLIT BËN NJË VETËDEKLARIM TË SIPËRFAQES SË TRUALLIT NË PËRDORIM, PRANË BASHKISË KU NDODHET TRUALLI, (TEK DREJTORIA E TATIM TAKSAVE).

KATEGORITË MINIMALE TË TRUALLIT JEPEN NË ANEKSIN QË I BASHKËLIDHET KËTIJ LIGJI. PËR ÇDO KATEGORI MINIMALE TË TRUALLIT, KËSHILLI BASHKIAK MUND TË MIRATOJË NËNKATEGORIZIME.

2. NIVELI I TAKSËS ÇAKTOHET NË LEKË PËR METËR KATROR. DETYRIMI I TAKSËS LLOGARITET SI SHUMËZIM I NIVELIT TË TAKSËS ME BAZËN E TATUESHME. NIVELET TREGUESE TË TAKSËS, PËR ÇDO KATEGORI MINIMALE TË BAZËS SË TAKSËS, JEPEN NË ANEKSIN 2.1, TË KËTIJ LIGJI.

3. TAKSA E MBLEDHUR, NË MBËSHTETJE TË KËTIJ LIGJI, PAGUHET NË BUXHETIN E BASHKISË, NË TERRITORIN E SË CILËS NDODHET PRONA E TAKSUESHME.”.

	VLERA E TAKSËS NË LEKË/M2/VIT PËR QËLLIME BANIMI NGA INDIVIDËT	VLERA E TAKSËS NË LEKË/M2/VIT PËR QËLLIME BIZNESI
BASHKITË E GR III-TE	0,14 LEKE M <sup>2</sup> NE VIT	12 LEKE M <sup>2</sup> NE VIT

**3- TAKSA E FJETJES NE HOTEL**

Me “hotel” do te kuptohet cdo veprimtari, qe jep strehim kundrejt pageses dhe perfshin njerin ose disa nga emertimet se bashku: hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtepi pritjeje, turizem familjar dhe cdo objekt tjetër qe perdoret per kete qellim, pavaresisht emertimit qe mban.

Baza e taksës se fjetjes ne hotel, eshte çmimi i fjetjes, sipas rastit, per dhome ose per person, per nje nate.

Detyrimi per taksën llogaritet si shumezim i nivelit te taksës me çmimin e fjetjes dhe numrin e neteve te qendrimit ne hotel.

Detyrimi per taksën i takon klientit qe strehohet ne hotel, detyrim i cili, mbahet nga hoteli per llogari te Bashkise Himare dhe derdhet ne favor te Bashkise brenda dates 5 te muajit pasardhes. Ne faturen e hotelit shenohet çmimi i fjetjes dhe mbi te vlere e taksës.

Niveli i taksës qe aplikohet eshte ne masen 33 der 115 leke te çmimit te fjetjes per 1 nate, sipas klasifikimit te zonave dhe territorit, kurse sezoni llogaritet per 60 dite, sikurse sqarohet ne tabelen me poshte.

**Niveli i Taksës ne leke per 1 nate fjetje ne hotel, sipas zonave dhe llojit te Hotelit**

Zona	ZONA A Njesia Administ.Himare	ZONA B Njesia Administ.Lukove	ZONA C Njesia Administ.Hore-Vranisht
	<b>HIMARE</b>	LUKOVE	VRANISHT
Emertimi			
Hotele	<b>115 leke per 1 nate</b>	100 leke per 1 nate	100 leke per 1 nate
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	<b>40 leke per 1 nate</b>	35 leke per 1 nate	30 leke per 1 nate

## - Paketa Fiskale 2017 -

Subjektet që i nënshtrohen detyrimit të kësaj takse, janë të detyruar të mbajnë dhe evidentojnë në një libër të vecantë hyrjen dhe daljen e klienteve. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e taksës së fjetjes në hotel, është Drejtoria e Te ardhurave (Zyra e taksave Vendore) pranë Bashkisë Himare, ose Agjenti Tatimor sipas ligjit.

### 4- TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE NGA NDERTIMET E REJA

Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat perkatese percaktohen ne perputhje me legjislacionin ne fuqi per dhenien e lejes se ndertimit/zhvillimit, sipas parashikimeve te Ligjit.

1. Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

2. Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njërive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.

3. Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si për qindje e vlerës së investimit dhe është 1 deri në 3 për qind e kësaj vlere. Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit. Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit.

4. Këshilli bashkiak miraton kategori dhe nënkategori për klasifikimin e investimeve, të cilat mund të përdoren për vendosjen e nivelit të taksës.

5. Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

6. Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki." Baza e taksës është vlera në leke e investimit të ri që kërkohet të kryhet. Detyrimi për taksën i takon investitorit.

Niveli i taksës sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve ndërtimore, jo shteruese sipas Lejeve jipen në tabelën më poshtë :

Nr	Ndarja me zona e territorit të Bashkisë Himare për efekt taksimi	Niveli i taksës në % me vlerën e Investimit ose të shitjes		
		ZONA A	ZONA B	Shenime dhe Verejtje
		Dhermi, Palase, Ilias, Vuno, Himare, Qeparo, Q.Pali, Borsh, Lukove, Piqeras, Nivice, Shkalle, Shenvasil,	Kudhes, Pilur, Corraj, Fterre, Sasaj fshat si dhe ish territori i Komunes se Hore-Vranishtit.	
1	Ndertime per qellime; Objekte banimi, administrative, tregëtie, sherbimi etj qe kryhen nga shoqerite e Ndertimit, te cilat	6 % te cmimit te shitjes per meter	4 % te cmimit te shitjes per meter	

## - Paketa Fiskale 2017 -

	nuk destinohen per qellime turizmi, industrie apo perdorimi publik.	katror	katror	
2	Ndertime te ndryshme qe nuk bejne pjese dhe nuk perfshihen sipas pikes 1 me siper. Hoteleri te ndryshme, Sherbime Tregtare ne Turizem-Industri, Rezidenciale Turistike, Resorte, Komplekse Turistike, Agro-Turizem, Sherbime Publike, Objekte Publike, Bare-Restorante ne Sherbim te Turizmit, Objekte Sportive, Objekte te ndryshme Bashkiake, Kamping, Kazino, Marina dhe Park per Jahte dhe Sherbimet Perkatese etj..	3 % te vleres se Investimit	1 % te vleres se Investimit	
3	Objekte te subjekteve private per qellime sherbimi; Kopshte, Cerdhe, Shkolla, Spitale. Ndertime infrastrukture private si; rruge, kanalizime, ujesjellsa, ndricimi, parkimi, telefonie, e te ngjajshme	3 % te vleres se Investimit	1 % te vleres se Investimit	
4	Ndertime ne proces legalizime te reja	0,5 % te vleres se Investimit	0,5 % te vleres se Investimit	
5	Leje zhvillimore komplekse per ndertim -in e rrugeve Kombetare, porteve, aero-porteve, tuneleve, digave, ndertim infrastrukture ne energji elektrike, perfshire dhe makineri e pajisje per keto projekte,	0,1 % te vleres se Investimit	0,1 % te vleres se Investimit	

Per investimet sipas pikes 4 te tabelës me lart, taksa e ndikimit ne infrastrukture eshte ne masen 0.1%, por jo me pak se kostoja e rehabilitimit te infrastruktures se demtuar.

Struktura e ngarkuar per llogaritjen, leshimin e autorizimit dhe ndjekjen e pageses perkatese te taksës se ndikimit ne infrastrukture eshte Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit te Teritorit prane Bashkise Himare.

### 5- TAKSA MBI KALIMIN E TE DREJTËS SE PRONËSISË PER PASURITË E PALUAJTSHME

Taksa mbi kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme vendoset per ndertesat dhe te gjitha pasurite e paluajtshme ne çastin e kalimit te se drejtes se pronesise mbi to.

Taksa paguhet nga personi, qe kalon te drejten e pronesise mbi pasurine e paluajtshme, para kryerjes se regjistrimit, ne perputhje me aktet ligjore ne fuqi.

Baza e taksës mbi kalimin e se drejtes se pronesise, per ndertesat eshte siperfaqja e ndertimit, sipas aktit te pronesise, pronesia e se ciles transferohet. Niveli i taksës caktohet ne leke per meter katror te bazës se taksës.

Detyrimi tatimor llogaritet si shumezim i nivelit te taksës me bazen e tij.

Ne rastet kur pranohet nga vete palet ose kur vertetohet ligjerisht simulim i dhurimit per llogari te nje shitjeje, per shmangie nga taksa, zbatohet taksa sa dyfishi i vleres, pavaresisht nga pergjegjesite e tjera sipas ligjeve ne fuqi.

#### a- Taksa mbi kalimin e te drejtes se pronesise per pasurit e paluajtshme

Kjo takse aplikohet per pasurite e paluajtshme, toka, troje, ndertesa etj dhe llogaritet e paguhet ne momentin e kalimit te te drejtes se pronesise dhe xhirohet per cdo rast ne llogarine e Bashkise nga organi perkates.

Nr	Pershkrimi i emertimit te llojit te prones	Taksa leke per m <sup>2</sup>
1	Toke bujqesore dhe kullota	2% te vleres
2	Troje	2% te vleres
3	Ndertesa banimi	100 lek/m <sup>2</sup>

## - Paketa Fiskale 2017 -

4	Ndertesa per tregeti dhe sherbime	300 lek/m <sup>2</sup>
5	Ndertesa te tjera	200 lek/m <sup>2</sup>

### **b- Perjashtimi nga taksa e kalimit te pasurise**

Perjashtohen nga taksa per kalimin per pasurite e paluajtshme :

**b/1-** Enti Kombetar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;

**b/2-** Personat, te cilet jane subjekt i tatimit mbi te ardhurat vetjake, ne mbeshetje te ligjit nr.8438, date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat" i ndryshuar;

**b/3-** Subjektet qe dhurojne pasuri te paluajtshme kur perfitues te drejtperdrejte jane:

-) institucionet dhe entet shtetore e publike, qendrore e vendore;

-) bashkesite fetare ose organizatat jofitimprures, kur dhurimi lidhet me ate pjese te veprimtarise se tyre pa qellim fitimi.

Ne keto raste dhuruesi, pasi ka marre vertetimin nga keshilli bashkiak per perjashtimin nga taksa, ben rregjistrimin e pasurise se paluajtshme te dhuruar.

Ne çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesen qe i takon agentit te taksave.

### **c- Agjenti tatimor**

Agjenti per vjeljen e taksës mbi kalimin e se drejtes se pronesise per pasurite e paluajtshme, eshte Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme, e cila, perfiton 3 % te shumës se arketuar dhe diferencen e derdh per llogari te Bashkise jo me vone se data 30 e muajit pasardhes.

## **6- TAKSA E RREGJISTRIMIT TE PERVITSHEM TE MJETEVE**

Kjo takse llogaritet per te gjitha mjetet ne pronesi te qytetareve, subjekteve dhe institucioneve dhe niveli i taksimit behet sipas vendimit te Qeverisjes qendrore dhe legjislacionit ne fuqi.

Organi i vetem per vjeljen e kesaj takse, eshte Drejtoria Rajonale e rregjistrimit dhe e kontrollit te Automjeteve, e cila ne kete rast luan edhe rolin e Agjentit Tatimor.

Zyra e Taksa dhe Tarifave vendore prane Bashkise ne bashkepunim me Drejtoria e Sherbimeve publike dhe Infrastruktures, Zyra perkatese e Lejeve te transportit, mban Rregjistrin Themeltar te Mjeteve ne territorin e Bashkise Himare, ben evidentimin dhe rregjistrimin e mjeteve ne te gjithë territorin e saj dhe respektivisht ne cdo tre muaj ben reakordinin sasi-leke me Drejtorine Rajonale te rregjistrimit dhe kontrollit te mjeteve per shumet e xhiruara ne llogari te Bashkise per kete takse nga kjo Drejtori.

## **7- TAKSA E TABELES**

Taksa e tabelës aplikohet per subjektet tregtare qe ushtrojne veprimtari nen juriksionin e Bashkise Himare, dhe, vendosin emrin/emertimin ose cdo te dhene tjeter, ne njesine ku zhvillojne aktivitetet.

Vendosja e tabelës eshte e detyrueshme per te gjithë subjektet me perjashtim te ambulanteve, tregtareve qe ushtrojne aktivitet ne tregjet e miratuara, mjetet e transportit rrugor dhe detar.

Kategorite dhe niveli i taksës jepet ne tabelen e meposhtme:

### **- Taksa e tabelës dhe e reklames**

Nr	Emertimi	Niveli i taksës
1	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim.	120 leke /ne vit
2	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme dhe e palëvizshme: - E Thjeshte	13 500 leke m <sup>2</sup> /vit
3	Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme dhe e palëvizshme: - Elektronike	27.000 leke ne vit
4	Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura,	



## - Paketa Fiskale 2017 -

	panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.	1000 leke/m <sup>2</sup> / ne dite
5	Tabelë për qëllime identifikimi mbi 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.	45,000 leke/m <sup>2</sup> ne vit

### 8- TAKSA VENDORE E PERKOHSHME

#### a- Takse per hapesirat publike

Nr	Emertimi	Niveli i takses
1	Subjektet qe shfrytezojne hapesirat publike jashte gentplanit te miratuar aplikohet takse	66 leke / m <sup>2</sup> ne muaj.
2	Subjektet qe shfrytezojne hapesirat publike jashte gentplanit te miratuar, vetem gjate sezonit turistik	66 leke / m <sup>2</sup> ne muaj .

Struktura kompetente per dhenien e Lejeve per vendosjen e tabelave dhe vjeljen e tyre eshte Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit te Territorit, prane Bashkise Himare.

#### b- Taksa e parkimit te automjeteve ne siperfaqet publike ne qytet dhe sheshe e rruge

Nr	Emertimi i llojit te automjeteve	Niveli i takses leke ne muaj	Parkim i rezervuar Pagesa vjetore ose me kontrate dhe me parapagim
	<b>Transport pasagjeresh</b>		
1	Automjete deri ne 5 vende	2000	20.000
2	Automjete 6-9 vende	2500	25.000
3	Automjete 10-25 vende	3500	35.000
4	Automjete 26-42 vende	4000	40.000
5	Automjete mbi 42 vende	4500	45.000
	<b>Transport mallrash</b>		
6	Automjete deri ne 2 ton	3000	30.000
7	Automjete 2-5 ton	4000	40.000
8	Automjete 5-10 ton	5000	50.000
9	Automjete 10-16 ton	6000	60.000
10	Automjete mbi 16 ton	7000	70.000
11	Parkimi orar me pagese per vetura ne sheshe,qendra..	50 leke/ora	
12	Parkimi orar me pagese per mikrobuza	70 leke/ora	
13	Parkimi orar me pagese per autobuza	100leke/ora	
14	Parkimi i organizuar nga Bashkia ne vende te caktuar	100 lek/ne 8 ore	300 lek/ne 24ore

-Organi qe mbledh taksen e parkim i rezervuar dhe me kontrate per subjektet eshte Zyra taksave qe organizon, kontraktin dhe faturon cdo subjekti sipas tarifave te mesiperme, kurse parkimi me pagese orare organizohet nga Drejtoria Ekonomike dhe e Taksave me punonjes te vecante dhe mbeshtetet nga Policia Bashkiake per vjeljen e saj sipas te gjitha normave e rregullave fianciare dhe ato te qarkullimit rrugor. Rregullat me te detajuara te organizimit te vjeljes se tarifave te parkimit, te vendparkimeve etj, percaktohen me Urdherese te vecante nga Kryetari i Bashkise.

## II-TARIFAT VENDORE

### 1.Tarife sherbimi per ndricim, gjelberim dhe sherbime te tjera.

Nr	Emertimi	Niveli i tarifës (leke/vit)
1	Subjekte ambulante dhe taksi	2 400
2	Subjekte me xhiro deri ne 5 milione leke ne vit	4 000
3	Subjekte me xhiro 5 deri ne 8 milione leke ne vit	14 000
4	Subjekte biznesi i madh	56 000
5	Subjekte qe ushtrojne aktivitet ndertimi	56 000
6	Institucione publike dhe private	56 000
7	<b>Tarife ndricim-gjelberim-sherbime publike per familjaret</b>	
	a- <u>Familjet ne fshatrat e ish Komuna Hore-Vranisht dhe fshatrat Pilur-Kudhes, Corraj, Fterre dhe Sasaj fshat.</u>	<b>600 leke ne vit</b>
	b- <u>Te gjitha familjet e tjera ne territorin e Bashkise</u>	<b>1200 leke ne vit</b>

#### 1.1 Tarife ndricim, gjelberim, sherbime per subjektet e transportit

Nr	Emertimi i aktivitetit	Tarifa leke ne vit
	<b>Transport pasagjeresh</b>	
1	Automjete deri ne 5 vende	2,900
2	Automjete 6-9 vende	5,600
3	Automjete 10-25 vende	6,400
4	Automjete 26-42 vende	7,200
5	Automjete mbi 42 vende	8,000
	<b>Transport mallrash</b>	
6	Automjete deri ne 2 ton	3,200
7	Automjete 2-5 ton	4,000
8	Automjete 5-10 ton	5,600
9	Automjete 10-16 ton	6,400
10	Automjete mbi 16 ton	8,800
	<b>Transport Ujor</b>	
11	Transport detar brenda vendit	8,000
12	Transport udhetare jashte vendit	12,000
13	Varka per shetitje	2,400

### 2.TARIFA E SHERBIMIT VETERINAR

#### a. Per subjektet qe i nenshtrohet detyrimit te pageses se takses vendore per biznesin e vogel

Nr	Aktivitet / Xhiro leke	Subjekte me xhiro nga 0 deri ne 5 milione leke ne vit	Subjekte me xhiro nga 5 deri ne 8 milione leke ne vit
1	Shitje me pakice	7500	8800
2	Shitje me shumice	9500	9600
3	Prodhim	9000	9600

#### b. Per subjektet Juridike me aktivitet tregetar,prodhues dhe stabilimente frigoriferike.

Nr	Emertimi	Niveli i tarifës ne vit ( leke)
1	Subjekte juridike me xhiro deri 8 deri 20 miljon lek ne vit	20 000
2	Subjekte juridike me xhiro 20 – 50 miljon lek ne vit	32 000
3	Subjekte juridike me xhiro mbi 50 miljon lek ne vit	60 000

## - Paketa Fiskale 2017 -

### 3.TARIFA VJETORE E PASTRIMIT URBAN

#### a.Per subjektet qe i nenshtrohet detyrimit te takses vendore

Nr	Aktivitet/ Sipas natyres se Biznesit	Tarifa, leke/ne vit
1	Restorante, Fruta Perime, Shitje me shumice ushqimore,	28.000
2	Subjekte me veprimtari ndertimet, (Per cdo leje ndertimi qe merr)	56.000
3	Fabrika vaji, dhe subjekte me Veprimtari prodhuese te tjera	40.000
4	Hoteleri dhe dhoma me qera, (Pa restorant) (Per cdo dhome) 1200 lek/vit	(nr.dhomave x 1200 leke)
5	Bar-Kafe, Fast Food etj te ketij lloji,	24.000
6	Subjekte sherbimi te te gjitha llojeve,	8.000
7	Profesione te lira dhe subjekte Ambulante e sezonale e te tjera	8.000
	<b>Trasport pasagjeresh</b>	
7	Automjete deri ne 5 vende	1 600
8	Automjete 6-9 vende	3 120
9	Automjete 10-25 vende	3 520
10	Automjete 26-42 vende	4 000
11	Automjete mbi 42 vende	4 240
	<b>Trasport mallrash</b>	
12	Automjete deri ne 2 ton	1 760
13	Automjete 2-5 ton	2 240
14	Automjete 5-10 ton	3 120
15	Automjete 10-16 ton	3 520
16	Automjete mbi 16 ton	4 800
	<b>Trasport ujqor</b>	
17	Trasport detar jashte vendit	4 400
18	Trasport udhetare brenda vendit	4 000
19	Varka per shetitje	1 200

#### b.Tarifa e pastrimit urban Per familjet dhe tregjet e qytetit,

(leke ne vit)

Nr	Emertimi	Niveli i tarifes ne leke
1	Per familje, (Himara me fshatra dhe Lukova me fshatra,pervec Corraj,Fterre,Sasaj).	1200 (leke ne vit)
2	Per familjet, ( Fshati Kudhes,Pilur, Hora me fshatra si dhe Corraj,Fterre,Sasaj)	600 (leke ne vit)
3	Per tregtare qe ushtrojne aktivitet ne tregjet e qytetit.	600 (leke ne muaj )

#### Shenim :

Tarifa e pastrimit per fshatin Kudhes,Pilur,Corraj,Fterre,Sasaj dhe ish Komuna Hor-Vranisht me te gjitha fshatrat do te jete ne masen 600 leke ne vit. Per te gjitha fshatrat dhe qendrat e tjera 1200 lek/vit.

Per kategorite subjekte "ndertimi" llogaritja e tarifave te pastrim-ndricim-gjelberim-sherbime do te behet nga momenti i marrjes se lejes ndertimit deri ne momentin e dorezimit te objektit dhe te paraqitjes te kerkeses per marrjen e lejes se shfrytezimit. Llogaritja behet per cdo vit kalendarik. Ne subjekte te kesaj kategorie futen kontraktore dhe nenkontraktore ndertimi te rregjistruar ne QKR, pamvaresisht xhiros.

Bizneset sezonale do te paguajne tarifen e pastrimit per gjithe periudhen vjetore.

#### c. Tarife pastrimit Per subjektet Juridike

Nr	Emertimi i subjektit sipas klasifikimit te tyre	Niveli i tarifes ne vit Ne ( leke)
1	<b>Per subjekte me aktivitet tregetar</b>	
1.1	Subjekte juridike me xhiro deri 10 miljon	20 000
1.2	Subjekte juridike me xhiro 10 deri 20 miljon	32 000
1.3	Subjekte juridike me xhiro mbi 20 miljon	48 000

## - Paketa Fiskale 2017 -

2	<b>Per subjekte me aktivitet prodhues</b>	
2.1	Subjekte juridike me xhiro deri 10 milion	16 000
2.2	Subjekte juridike me xhiro 10 deri 20 milion	40 000
2.3	Subjekte juridike me xhiro mbi 20 milion	64 000
	<b>Per subjekte me aktivitet sherbimi</b>	
3.1	Subjekte juridike me xhiro deri 10 milion	24 000
3.2	Subjekte juridike me xhiro 10 deri 20 milion	40 000
3.3	Subjekte juridike me xhiro mbi 20 milion	56 000
4	Profesioni i lire	
4.1	Studio ligjore, kontabiliteti konsulence, Farmaci, Stomatologji Laborator mjeksor e dentar dhe te ngjashme	8 000
4.2	Studio projektimi, arkitekture, gjeodet e te ngjashme	8 000
4.3	Angjesi doganore, sigurime, bankar, broker, kembimi valuator, krediti, tranferta e te ngjashme	8 000
5	Fondacione OJF e te ngjashme	8 000
6	Institucione financiare si banka, shoqeri sigurimesh, tranferta e te ngjashme	32 000
7	Lojra fati, veprimtari sportive e te ngjashme	
7.1	Per vendodhjen kryesore dhe filjale	64 000
7.2	Per cdo aktivitet dytesor	40 000
8	Per subjektet e ndertimit	
8.1	Per vendodhjen kryesore dhe filjale	80 000
8.2	Per cdo aktivitet dytesor	40 000

#### 4. Tarifa per leje, autorizime dhe vertetime te leshuara nga Administrata

Nr	Emertimi	Niveli i tarife ne leke
1	Leje sanitore – veterinare per subjekte tregetie ambulante produkte shtazore	800
2	Leje sanitore – veterinare per subjekte fizike tregeti produkte shtazore	2400
3	Leje sanitore – veterinare per subjekte juridike tregeti produkte shtazore	4 000
4	Certifikate veterinare per eksport produkte blegtorale, (per cdo rast)	1 600
5	Kontroll i produkteve me origjine shtazore, (per cdo rast ose mjet)	800
6	Kontroll e leshim raporti per tregeti produkte origjine shtazore (per krere)	160
7	Pajisje me certifikate veterinare per kullota dhe shtegetim bagetie	800
8	Pajisja me raport veteriner per tregetimin e produkteve shtazore dhe te detit	240
9	Vertetim pronesie nga zyra e Kadastres me skicim	400
10	Dhenie e leje rrethimi te prones me dokumenta azhornimi per m2	12/lek m <sup>2</sup>
11	Azhornimi ne terren i prones dhe vendosje piketa me kufitaret	40.000
12	Azhornim terreni dhe zgjidhje konflikti nga grupi i punes	3.200

#### 4.1 Tarifa te tjera per sherbime zyrtare

1	Autorizim per punime ne rruge	1600
2	Autorizim per vendosje banderolash te perkohshme	800
3	Autorizim per sherbim transporti jasht linje	400
4	Autorizim per levizje te automjeteve( transport nxenesish, furnizim malli ne subjekte, sherbime transporti ne subjekte e te ngjashme.)	800
5	Autorizim per strehim	800
6	Autorizime te tjera	800
7	Autorizim per privatizimet e kryera	800
8	Autorizim per privatizimet e reja	4 000

## - Paketa Fiskale 2017 -

9	Vertetime per pjesemarrje ne tender	400
10	Vertetime te tjera	80
11	Per vertetim pasurie e pronesia	400
12	Per vendime K.B te shkurtuara etj	160
13	Vertetim i njehesuar me origjinalin nga arkivi i Bashkise	160
14	Vertetim banimi dhe per shlyerje te detyrimeve vendore	160
15	Leshimi dhe njehesim i dosjeve te lejeve te ndertimit na drejtoria ose arkivi	4 000
	Leshim vertetim pronesia te tokes	240
16	Vertetim pronesia per cdo plan rilevimi	800
17	Fotokopjo dokumenti e njehesuar me origjinalin	160
17	Dhenie vendimi per Leje Rrethimi te prones	12 lek/m <sup>2</sup>
19	Azhornimi kadastral ne terren cdo parcele ne Himare	4 000
20	Azhornimi kadastral ne terren cdo parcele ne fshatrat e tjera te Bashkise	5 600

### 5. Tarifa sherbimi per subjektet qe ushtrojne aktivitet ne sektorin e ndertimit

Nr	Emertimi	Niveli i tarifes ne leke
1	Tarife sherbimi per aplikim per leje ndertimi te cdo lloji	4 000
2	Tarife sherbimi per kontrollin e piketimit te objektit	8.000
3	Tarife sherbimi per kontrollin e perfundimit te themelit	8.000
4	Tarife sherbimi per kontrollin e karabinase	8.000
5	Tarife sherbimi per kontrollin e perfundimit te objektit dhe sistemimin e ambjentit perrreth te tij. Lidhja me infrastrukturen publike egzistuese.	5.600
6	Tarife sherbimi per kontrollin e perfundimit te fasadave dhe rifiniturave	5.600
6.1	- Dhenie e leje shfrytezimi deri ne kater kate	5.600
6.2	- Dhenie e leje shfrytezimi mbi kater kate	+ 800 per cdo kat
7	Tarife sherbimi per vertetim konfirmim dokumenti te dale nga arkivi teknik i Drejtorise se Urbanistikes	
7.1	-per dokument ligjor	160 leke/cope
7.2	-per dokument teknik	400 leke/cope
8	Azhornim gentplani + 30 metra rreth prones qe azhornohe	36 leke/m <sup>2</sup>
9	Percaktimi i vendndodhjes objektit per qera, privatizim, shitblerje etj	4 800
10	Leshimi i gentplanit te paazhornuar te zones ku do ndertohet	
10.1	- Ne format A4	960 lek/copa
10.2	- Ne format A3	2560 lek/copa
11	Matja, percaktimi i zones se vendndodhjes objektit, azhornimi gentplanit sipas kerkeses per qera, privatizim, shitblerje etj.	4800

### 6- TARIFAT PER ZENIEN E HAPESIRAVE PUBLIKE

Baza e tarifave per zenien e hapësirave publike, është sipërfaqja në m<sup>2</sup> për sipërfaqet publike të zene nga subjektet për qëllime biznesi.

Tarifa për zenien e hapësirave publike, do të llogaritet si detyrim mujor i tatimpaguesit. Këshilli Bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e kësaj tarife, si dhe mund të caktojë nivele të ndryshme të kësaj tarife, sipas nivelit të zhvillimit të veprimtarisë së biznesit në zona të ndryshme të qendrës së banuar. Në këto mënyra, Njësia Administrative Vranisht dhe Lukovë, nivelin e tarifës për zenien e hapësirave publike do ta kenë 50 përqind më të ulët, përveç sipërfaqeve të plazheve.

Tarifa për zenien e hapësirës publike nuk zbatohet për hapësirat që nuk janë në pronësi dhe nën administrimin e pushtetit vendor.”.

Kategoritë dhe nenkategoritë e Tarifës për zenien e hapësirave publike, do të jenë si vijon:

## - Paketa Fiskale 2017 -

Nr	Emertimi i veprimtarise	Niveli i Tarifes sipas kohezgjatjes se kontrates				
		leke/m <sup>2</sup> ne muaj	leke/Ha ne 1 vit	leke/Ha 2-5 vjet	leke/Ha 6- 10 vjet	Leke per Km/1 vit
1	Per instalime linja te ndryshme, per veprimtari prodhuese dhe sherbimi, private e publike si energji elektrike e te ngjajshme	66 leke/m <sup>2</sup>				
2	Per qellime biznesi, tregëtie dhe sherbimi te te gjitha llojeve	66 leke/m <sup>2</sup>				
3	Per qellime biznesi jashte vendit te tregëtitimit si; vendosje mallrash, vendosje tavolina, siperfaqe te rrethuara sherbimi, me vazo, bime dekorative, platforma, kangjella, plastamas etj	66 leke/m <sup>2</sup>				
4	Per organizimin e spektakleve dhe te panairëve	66 leke/m <sup>2</sup>				
5	Per vendosje antena te telefonise fikse, te telef. te levizeshme, ato televizive, radiokomunikimit; Kullota, sipas VKM nr.391 dt.21.6.2006 ndryshuar me VKM nr.1064 dt. 22/12/2010, (lidhja 2 pika 7/4)			1-5 vjet 8500000	6-10 vjet 8000000	
6	Per ndertim teleferik, linja tensioni, agrogjeneratore, stacionet, bazament, objektet perkatese etj		192.000	184.000	176.000	
7	Per shtrirje linja ne siperfaqe si ndertim kanalesh, (uji, gazi) linjash te tensionit elektrik etj,(Kullota)					190.000
8	Per ndertim/perdorim rruge per lidhjen e siperfaqes se dhene ne perdorim me rrjetin		35.000			
9	Per ndertim rezervuaresh si dhe zhvillimin e akuakultures.			1-5 vjet 270.000	6-10 vjet 180000	
10	Vendosje Kaminash per prodhim qymyr dru dhe te eshkes, furra gelqereje, sheshe per depozitim e perkohshem te materjaleve etj		100.000			
11	Ndert. linje te tensionit te larte- Pyje-shkure					25.000
12	Per qellime kampingu dhe te tjera te ngjajshme	12,000 lek/ha ne muaj				
13	<b><u>Per cdo qellim tjeter qe nuk eshte perfshire me siper, per hapësirat publike dhe per pyje e kullota te kategorive te vecanta zbatohen tarifat e VKM nr.1064 date 20.06.2010 sipas percaktimeve.</u></b>		Kontrat <u>Per 1 vit</u>	Kontrat <u>2-5 vjet</u>	Kontrat <u>6-10 vjet</u>	
14	<b><u>Per nxjerrje, prodhim dhe depozitim materjalesh inerte dirrekt nga siperfaqia, (Inproduktive)</u></b>	-	540.000	495.000	440.000	-

- Tarifat per zenien e Hapesirave publike, sipas pikes 1,2,3,4 per Njesine Administrative Hore-Vranisht dhe per Njesine Administrative Lukove do te jete 50 perqind me e ulet, pervec sip.plazhi.
- Baze per llogaritjen e kesaj tarife, eshte VKM nr.391 date 21.6.2006 i ndryshuar me VKM nr. 1064 date 20.06.2010, "Per percaktimin e Tarifave ne sektorin e Pyjeve dhe te kullotave", dhe ne kete rast eshte konsideruar Tarife dhe jo takse, per efekt te kushtezimit te vendosjes te nivelit te Tarifes dhe detyrimit ligjor e pergjegjeshmerise se strukturave shtetore per mbledhjen e saj. Per te gjitha rastet e tjera qe nuk jane perfshire me siper do te zbatohet VKM nr.1064 dt.20.6.2010.
- Kjo tarife llogaritet dhe mblidhet sipas kushteve kontraktuale apo mareveshjeve te percaktuara midis Bashkise dhe subjektit fizik apo juridik qe ka ne perdorim keto hapësira. Per pikat 1-7, pervec pikes 5 per antena te telefonise celulare, likujdimi i shumes per shfrytezimin e siperfaqes behet ne momentin e nenshkrimtit te kontrates. Per piken 5 & 14 likujdimi i shumes se tarifës vjetore behet sipas dispozitave te kontrates nga subjektet e kontraktuara.
- Drejtoria e taksa-tarifave, organizon punen dhe ndjek detyrimin e saj per vjeljen e kesaj takse.

## - Paketa Fiskale 2017 -

### 7- Tarifa per destinacion qera kullota per blegtorine, grumbullim bime medicinale dhe te tjera (Per kullota, kaluar sipas VKM ne pronesi te Bashkise Himare dhe ligjit 9693 dt.19.3.2007)

Nr	Emertimi i subjektit ose llojit per shfrytezim kullota	Njesi matje	Niveli i tarifes per njesi
1	Qera kullota dimerore per bageti te imta – Qera kullota verore per bageti te imta -	Krere Krere	150 150
2	Qera kullota dimerore per bageti te trasha Qera kullota verore per bagetit e trasha	Krere Krere	1000 800
3	Dhenie sipërfaqe per grumbullim bime mjekesore,	Ha	12.000
4	Dhenie sipërfaqe per qellime te tjera shfrytezimi	Ha	12.000
5	Ngrehina bagetie ose per barinj dhe qendra stani	krere	40 lek/per krere
6	<u>Perdorim i sipërfaqeve kullosore e pyjore per qellime prodhimi</u>		
	a- <u>Shkarpa per furra gelqere etj .....</u>	<u>Mst</u>	<u>.....8</u>
	b- <u>Thupra dhe hunj etj.....</u>	<u>000/cop</u>	<u>.....80</u>
	c- <u>Kositje bar per blegtorine .....</u>	<u>Kv</u>	<u>.....80</u>
	d- <u>Rreshire pishe dhe te ngjashme.....</u>	<u>Kv</u>	<u>.....140</u>
	e- <u>Gurre, rrere dhe zhavore.....</u>	<u>M<sup>3</sup></u>	<u>.....16</u>
	f- <u>Humuse dhe te ngjashme.....</u>	<u>Kv</u>	<u>.....16</u>
	g- <u>Prodhim qymyr druri.....</u>	<u>Kv</u>	<u>.....80</u>
	h- <u>Per nxjerrje peme decorative me leje.....</u>	<u>cope</u>	<u>.....400</u>

Kjo tarife llogaritet dhe arketohet menjehere ne momentin e nenshkrimt te kontrates dhe mareveshjes zyrtare midis Bashkise dhe Fermerit ose subjektit perkates. Organi qe realizon llogaritjen dhe mbledhjen e kesaj tarife eshte Drejtoria e Pyje-Kullotave dhe mjedisit qe vepron ne perputhje me planin vjetor te shfrytezimit te kullotave, te pyjeve, te livadheve etj.

Kjo tarife eshte vetem per kontrata te perkoheshme sezonale brenda vitit, ndersa për kontrata dhe leje me afat me te gjate se nje vit, per tarifat do te vepronhet simbas Vendimit te KM nr.1064/2010.

Tarifat per perdorimin e sipërfaqeve per qellime prodhimi, aplikohet ne momentin kur subjekti ka marre lejen e miratuar nga organi Administrativ dhe kryen pagesen menjehere. Ndersa ne rastin ku subjekti ka nenshkruar nje Kontrate me organin Administrativ, pagesa kryhet sipas kushteve te kontrates.

### 8- Tarife sherbimi ne Tregjet Publike

nr	Emertimi i llojit te aktivitetit	Tarifa gjithsejt Ne dite	Pastrim	Ndricim	Gjelberim	Vrejtje
1	Per organizim spektakle dhe panaire	300	100	100	100	
2	Per qellime biznesi dhe tregjet e organizuar	300	100	100	100	
3	Per vendosje malli jashte ambjenteve tregut	300	100	100	100	
4	Per qellime biznesi ne vijen bregdetare	500	300	100	100	
5	Per qellime biznesi ne vende te tjera etj.	300	100	100	100	

### I- DISA RREGULLA PER TAKSA - TARIFAT

- 1- Vendimet e Keshillit Bashkise qe bien ndesh me kete vendim shfuqizohen.
- 2- Mbledhja e taksave do te kryhet nga strukturat e administrates se Bashkise ose nga agjenti fiskal, nese eshte perzgjedhur sipas ligjit nje i tille. Agjenti fiskal te shperblehet ne masen sipas ligjit por jo me shume se 5% te vleres se arketuar prej tij.

Kryetari i Bashkise perzgjedh dhe lidh kontrata me agjentin fiskal dhe percakton masen e shperblimit.

3- Per kreun I "Taksa vendore", pika 2, "taksa mbi pasurine e paluajtshme", pika 8, "taksa e tabeles dhe e reklames", pika 9, "taksa te perkohshme vendore";Kreu i II: Tarifat vendore, pika 3, "tarifa

vjetore e pastrimit urban", pika 1, "tarifa e shërbimit për ndricim dhe gjelberim në qytet" pagesa e takses dhe e tarifave nga tatimpaguesi do të arketohet brenda 4-mujorit të parë të vitit ushtrimor.

Për subjektet që rregjistrohen për herë të parë gjatë vitit në nivelin e takses do të jetë proporcionalisht më pjesën e mbetur të vitit.

4- Për kreun I "Taksa vendore", pika 3, "Taksa e fjetjes në hotel" pagesa nga tatim-paguesi do të behet brenda datës 5 të muajit pasardhës.

5- Për kreun I "Taksa vendore", pika 4, "Taksa e ndikimit në infrastrukture nga ndertimet e reja" do të mblidhet nga organi që leshon lejen e ndertimit dhe arketohet për çdo rast në llogari të bashkise.

6- "Tarifa e shërbimit për subjektet që ushtrojnë aktivitet në sektorin e ndërtimit" do të mblidhet nga Drejtoria e Palnifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe arketohet për çdo rast në llogari të Bashkise në momentin e kryerjes së shërbimit.

7- Për kreun II "Tarifa vendore", pika 3, "Tarifa e shërbimit veterinar" pagesa do të kryhet me dy keste nga subjekti: kesti i parë deri në 20 prill dhe kesti i dytë deri në 31 korrik.

8- Për kreun II "Tarifa vendore", "Tarifa e rregjistrimit të veprimtarive ekonomike", pagesa do të kryhet në momentin e rregjistrimit të subjektit në organin tatimor.

9- Për kreun I "Taksa vendore", pika 7, "Taksa për zënie dhe hapsirave publike", "taksa e zënies të hapsirave në tregje", pagesa do të kryhet nga subjekti deri në datën 10 të muajit pasardhës.

10- Për kreun II "Tarifa vendore" pika "Taksa për parkimin e automjeteve" pagesa do të kryhet në momentin e marrjes së lejes dhe /ose certifikates së transportit, do të mblidhet nga Drejtoria e Infstrukturës dhe Shërbimeve Publike dhe arketohet nga subjekti për çdo rast në arke ose llogarinë bankare të bashkise që shërbon në momentin e kryerjes së shërbimit.

11- Për tarifën sipas pikës II/6/14, Për hapësirat publike në Pyje-kullota për prodhim-depozitim inertë etj, arketimi do të behet menjëherë me dënimin e lejes së shfrytëzimit dhe për të gjitha rastet e tjera tarifën do të arketohen në llogarinë e bashkise në Bankë në momentin e kryerjes së shërbimit.

12- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria Pyje-Kullota, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Zyra e Gjendjes Civile, Institucionet e Vartësisë, Zyra Juridike, Policia Bashkiake dhe Inpektoriati Ndërtimor.

13- Kryetari i Bashkise nxjerr urdhra dhe udhëzime të vecanta për zbatimin e këtij vendimi.

14- Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015 dhe VKM nr.42/2015 "Për taksat vendore".

#### **15- ANKIMI**

Çdo taksapagues ka të drejtë të ankohet me shkrim për shumën dhe mënyrën se si janë vlerësuar detyrimet e tij, të kërkojë rimbursim si dhe të apelojë kundër çdo veprimi ose mosveprimi nga strukturat përkatëse në Bashkinë Himarë.

Ankimi paraqitet me shkrim pranë Kryetarit të Bashkise brenda 30 ditëve nga marrja e dijeni për aktin administrativ, dhe përmban të dhenat si më poshtë:

- a) emrin, adresën dhe NIPT-in e apellesit;
- b) vitin tatimor, me të cilin lidhet apeli;
- c) natyrën dhe shumën e tatimit ose gjobës që është subjekt apeli;
- d) baza ligjore ku mbështetet apeli.

Subjekti duhet të përmbushë kërkesat e ligjit për parapagimin e detyrimeve përpara depozitimit të ankimit administrativ.

Procedurat e apelit dhe procedurat e shqyrtimit të apelit tatimor, bazohen në përcaktimet e bëra në Ligjin nr.9920 "Për Procedurat Tatimore" dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të tij. Kryetari i Bashkise shqyrton ankimin dhe merr vendim brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit. Kundër vendimit të Kryetarit të Bashkise, subjekti ka të drejtë të ankohet në Gjykatë behet brenda 30 ditëve nga casti i marrjes së dijeni për vendimin e mesipër.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise dhe të gjithë Njesitë Administrative dhe Drejtoritë e Bashkise Himarë si dhe Ndërrmarjet apo Institucionet e tjera në varesi të saj.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit.

Projekti nga  
Irakli Gjicali

SEKRETARI KB  
Thodhori Beja

Zv.KRYETARI  
Stela Bezhani